

UDHËZUES I  
QYTETARËVE  
PËR AUTORITETET  
QEVERISËSE  
TË KOSOVËS





# UDHËZUES I QYTETARËVE PËR AUTORITETET QEVERISËSE TË KOSOVËS

Instituti i Menaxhimit Lindje-Perëndim, Inc. (EWMI)

Prishtinë

Prill 2003

Udhëzues i Qytetarëve Për Autoritetet Qeverisëse të Kosovës  
Botimi i parë, Prishtinë, 2003

Botuar nga:

Instituti i Menaxhimit Lindje-Perëndim, Inc. (EWMI) - Projekti i OJQ-ve Kosovare për Avokim (KNAP)

Botimi i këtij udhëzuesi u bë i mundur nga një grant i Agjencisë Kanadeze për Zhvillim Ndërkombëtar (CIDA).

Autorë: Fron Nazi, EWMI dhe Amy Horton, ICNL

Dizajni i produksionit: Fron Nazi dhe Lirijon Kadriu

Përkthyer nga: Kimete Klenja, EWMI

Redaktuar nga: Haki Abazi, IOM/KTI-KNAP dhe Kimete Klenja

Dizajni: d-line advertising, [lirijon@d-line.info](mailto:lirijon@d-line.info)

Ilustrues: Veli Blakçori

Shtypur në Dukagjini, Pejë

© 2003 Të gjitha të drejtat e rezervuara. Për riprodhim të këtij udhëzuesi ose të ndonjë pjese të tij, ju lutemi të kontaktoni EWMI-n. c/o ATRC, rr. Agim Ramadani (ish Ramiz Sadiku), 15 - Prishtinë, Kosovë  
Tel. / Faks: +381 (0) 38-244 810, e-mail: [atrcknap@yahoo.com](mailto:atrcknap@yahoo.com)

## Projekti i OJQ-ve Kosovare për Avokim (KNAP)

Qëllimi i Projektit të OJQ-ve Kosovare për Avokim, një marrëveshje bashkëpunimi mes USAID-it dhe Institutit të Menaxhimit Lindje-Perëndim, Inc., është avancimi i rolit të OJQ-ve në avokim duke ndihmuar në transformimin e tyre nga siguroes të shërbimeve reaktive në agjentë proaktivë të ndryshimit. Këto objektiva të KNAP-it janë arritur përmes një kombinimi trajnimesh, programeve të mentorimit dhe dhënies së granteve. Partneri kryesor vendas është Fondacioni për Iniciativë Demokratike dhe Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim.

### Instituti i Menaxhimit Lindje-Perëndim, Inc.

Instituti i Menaxhimit Lindje-Perëndim, Inc. (EWMI) është një organizatë jofitimprurëse me qendër në Nju Jork, e cila promovon reformat ligjore dhe ekonomike në vendet në tranzicion drejt ekonomisë së tregut të lirë. EWMI ofron këshillim dhe shërbime teknike për reformat ligjore dhe rregullative, zbatimin e ligjit, privatizimin, ristrukturimin e ndërmarrjeve, si dhe zhvillimin e tregjeve të kapitalit.

Duke pasur parasysh rëndësinë që ka shoqëria civile në konsolidimin e reformave ekonomike e ligjore, EWMI përkrah, po ashtu, organizatat vendase joqeveritare (OJQ-të), përmes trajnimeve, mundësive për rrjetëzim ndërkombëtar dhe granteve.

### Fondacioni për Iniciativë Demokratike

Fondacioni për Iniciativë Demokratike (FDI), i themeluar në tetor të vitit 2001, është partneri kryesor në zbatimin e KNAP-it. FDI-ja është një fondacion mbarë-kosovar që jep grante për OJQ-të dhe shoqatat kosovare që synojnë të krijojnë një shoqëri demokratike dhe të hapur.

FDI-ja është bërë një forcë udhëheqëse në promovimin dhe financimin e programeve për të drejtat e njeriut, çështjet gjinore, reformat në ekonominë e tregut, ekologjinë dhe shoqërinë civile. FDI-ja, strategjikisht e vendosur në Gjakovë, i përgjigjet nevojës për t'iu qasur zonave rurale, të cilat gjithmonë kanë qenë të anashkaluara.

### Qendra Ndërkombëtare për Ligjin për Organizatat Joqeveritare

Qendra Ndërkombëtare për Ligjin për Organizatat Joqeveritare (ICNL) është një organizatë ndërkombëtare misioni i së cilës është të lehtësojë dhe mbështesë zhvillimin e shoqërisë civile dhe lirinë e shoqatave. Ajo punon me partnerët vendas në tërë botën për të siguruar ndihmesë teknike për krijimin dhe përmirësimin e ligjeve që nxisin dhe regullojnë sektorin jopërfitues, joqeveritar (OJQ-të). ICNL-ja dhe partneri i saj vendas Instituti Kosovar për Ligjin për Organizatat Joqeveritare (IKDO) janë përgjegjës për komponentin e mbështetjes ligjore të KNAP-it që i asiston OJQ-ve vendase në zhvillimin e procedurave dhe rregullave për rregullimin e pjesëmarrjes, për të siguruar që përpjekjet e avokimit të OJQ-ve janë të kuptimta dhe efektive.



# HYRJE NË AUTORITETET QEVERISËSE TË KOSOVËS

Ka rreth katër vjet që nga përfundimi i luftës dhe Kombet e Bashkuara morën në dorë kontrollin e përkohshëm administrativ të Kosovës, duke mbajtur pezull një zgjidhje përfundimtare politike të statusit të saj. Gjatë këtyre katër viteve, kosovarët kanë qenë intensivisht të përfshirë në punën e nevojshme për të krijuar një mënyrë më të mirë jetese për të gjithë në Kosovë. Gjithashtu gjatë këtyre katër viteve, "UNMIK-u" është bërë pjesë e sfondit politik, me ndërkombëtarë të shumtë që vijnë për të ndihmuar në hartimin e ligjeve, ndërtimeve të sistemeve demokratike, dhe themelimin e institucioneve kalimtare të qeverisjes - të gjithë me qëllimin për të promovuar "autonomi substanciale dhe vetëqeverisje kuptimplote" në Kosovë.

Por, katër vjet pas përfundimit të luftës, shumë kosovarë e kanë pyetur veten rreth autoriteteve që e mbikqyrin Kosovën: Kush po e drejton Kosovën? Cila është baza e ligjeve? Cilat janë përgjegjësitë e zyrtarëve të zgjedhur? Çfarë janë marrëdhëniet midis UNMIK-ut, Kuvendit dhe Komunave? Si mund të dëgjohet zëri i qytetarit nga qeveritarët në Kosovë?

Ky udhëzues ofron përgjigje për disa nga këto pyetje. Shumë aspekte të qeverisjes në Kosovë po ndryshojnë me shpejtësi. Aspekte të tjera nuk kuptohen plotësisht, madje edhe nga ata njerëz puna e të cilëve është qeverisja. Kështu, ky udhëzues nuk do t'i ketë të gjitha përgjigjet, por do të bëjë hapin e parë për t'ju ndihmuar të kuptoni autoritetet tuaja qeverisëse. Ai gjithashtu do t'ju informojë për disa nga mënyrat se si ju mund të merrni një rol në formimin e ligjeve dhe politikave që po zhvillohen tani në Kosovë.


Si me çdo demokraci të re dhe ndërtimin e strukturave të reja qeverisëse, bëhen gabime, përhapet konfuzion dhe progresi mund të jetë i ngadaltë në Kosovë. Megjithatë, një parim bazë ngelet i vërtetë: individët që janë të informuar rreth strukturave, pushtetit dhe funksioneve të qeverisjes së tyre janë në një pozitë më të mirë për të ndikuar në atë qeveri. Ne shpresojmë se ky udhëzues do t'ju informojë dhe frymëzojë njëkohësisht që të angazhoheni për të siguruar se qeveria juaj është përgjegjëse për nevojat, idetë dhe shqetësimet e popullsisë në Kosovë.





# PËRMBAJTJA

I.	Qeveria Qendrore: Si duket Qeveria Qendrore dhe çfarë bën ajo?	09
1.	Cilat janë autoritetet qeverisëse në Qeverinë Qendrore?	09
	a. Diagram	
2.	Cilat janë burimet e autoritetit për PSSP-në, UNMIK-un dhe Institucionet Kalimtare?	09
3.	Çfarë strukture ka UNMIK-u?	11
	a. Diagram	
4.	Çfarë janë Institucionet Kalimtare të Qeverisë Qendrore?	13
	a. Çfarë është Kuvendi?	13
	1. Diagram	
	b. Çfarë është Dega Ekzekutive?	15
	2. Diagram	
	c. Çfarë është Gjyqësori?	17
	3. Diagram	
II.	Pushteti i Rezervuar dhe i Transferuar: Kush është përgjegjës për çfarë?	19
III.	Pjesëmarrja e Publikut/ Qeveria Qendrore?	21
	a. Si mundet një anëtar i publikut të iniciojë miratimin e një ligji?	21
	1. Diagram	
IV.	Qeveria Komunale: Çfarë është Qeveria Komunale?	23
1.	Çfarë janë Institucionet Kalimtare të Qeverive Komunale të Kosovës?	23
	a. Diagram	
2.	Kush dhe çfarë janë Autoritetet Qeverisëse në Komuna?	23
3.	Cilat janë përgjegjësitë e Qeverisë Komunale?	24
4.	Pjesëmarrja në Qeverinë Komunale	25
	a. Si mund të marr pjesë unë në Qeverinë time Komunale?	25
	b. Si t'i bëj petition Qeverisë time Komunale?	27
	1. Diagram	
	c. Si të ankojem për një vendim administrativ?	29
V.	Mirënjohje	30



# QEVERIA QENDRORE:

## Si duket Qeveria Qendrore dhe çfarë bën ajo?

### 1. Cilat janë autoritetet qeverisëse në Qeverinë Qendrore?

Autoritetet qeverisëse në Qeverinë Qendrore janë:

**PSSP:** PSSP-ja (Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara) është autoriteti më i lartë administrativ qeverisës në Kosovë. PSSP-ja ka gjithashtu mandat, nga Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit, për të zhvilluar institucionet kalimtare demokratike vetëqeverisëse dhe mbikqyrur transferimin e përgjegjësive të administratës civile nga UNMIK-u tek "Institucionet Kalimtare".

**UNMIK:** UNMIK-u (Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë) është institucioni që ushtron kontrollin administrativ të PSSP-së në Kosovë. Menjëherë pas luftës, UNMIK-u kreu të gjitha funksionet dhe shërbimet bazë administrative si shëndetësi, arsim, shërbimet bankare dhe financiare, telekomunikacion dhe ligj e rend. Gradualisht, përgjegjësia për këto funksione po transferohet tek Institucionet Kalimtare, por UNMIK-u dhe PSSP-ja ende kanë përgjegjësinë më të lartë.

**Institucionet Kalimtare të Vetëqeverisjes (SIKV):** SIKV-të janë institucione qeverisëse të përkohshme, kalimtare - Kuvendi, Ministrinë dhe Gjyqet - të themeluara nga PSSP-ja. Ato ushtrojnë "përgjegjësi" të caktuara me qëllim zhvillimin e vetëqeverisjes kuptimplotë në Kosovë në pritje të një vendimi përfundimtar.


### 2. Cilat janë burimet e autoritetit për PSSP-në, UNMIK-un dhe Institucionet Kalimtare?

Dy dokumente ligjore i përshkruajnë autoritetet ligjore për pushtetet qeverisëse në Kosovë:

**Rezoluta 1244:** Në Qershor të vitit 1999, lufta përfundoi me miratimin e Rezolutës 1244 nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Rezoluta i jep PSSP-së, në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare dhe përmes UNMIK-ut, të drejtën mes të tjerash për:

- Të ushtruar kontrollin më të lartë administrativ në Kosovë;
- Të zhvilluar institucionet vetëqeverisëse demokratike kalimtare; dhe
- Të mbikqyrur transferimin e përgjegjësive të administratës civile nga UNMIK-u tek këto institucione.


**Korniza Kushtetuese (Rregullorja 2001/9):** Kjo është një rregullore e miratuar nga UNMIK-u/PSSP-ja në vitin 2001 e cila vendosi një kornizë për vetëqeverisjen kalimtare në Kosovë. Ajo themelon Institucionet Kalimtare dhe kalon përgjegjësi të kufizuara në to.



### 3. Çfarë strukture ka UNMIK-u?

UNMIK-u përbëhet nga katër "shtylla", ku secila përfaqëson një aspekt të mandateve të Kombeve të Bashkuara. Çdo shtyllë i raporton PSSP-së:

- Shtylla I: Policia dhe Drejtësia, nën Kombet e Bashkuara Përgjegjëse për policinë, burgjet, gjyqet, etj.
- Shtylla II: Administrata Civile, nën Kombet e Bashkuara Përgjegjëse për shërbimet publike, regjistrimin e popullsisë, etj.
- Shtylla III: Demokratizimi dhe Ndërtimi i Institucioneve, i udhëhequr nga Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) Përgjegjëse për organizimin e zgjedhjeve, përfshirë edhe hartimin e bazës ligjore për zgjedhjet.
- Shtylla IV: Rindërtimi dhe Zhvillimi Ekonomik, i udhëhequr nga Bashkimi Evropian (BE) Përgjegjëse për sistemin bankar, politikat fiskale, tregtinë dhe industrinë, etj.
- KFOR-i vepron jashtë strukturës së shtyllave.



#### 4. Çfarë janë Institucionet Kalimtare të Qeverisë Qendrore?

##### a. Çfarë është Kuvendi?


- Është dega legjislative e qeverisë, që do të thotë se ai miraton ligjet që e qeverisin Kosovën. (Ligjet nuk janë efektive derisa ato nuk shpallen zyrtarisht të vlefshme nga PSSP-ja).
- Përbëhet nga 120 anëtarë, që zgjidhen nga populli i Kosovës përmes zgjedhjeve demokratike dhe që shërbejnë për një afat prej 3 vjetësh. Në Kosovë deri më tani ekziston sistemi proporcional i zgjedhjeve.
- Zgjedh Presidentin e Kosovës, që përfaqëson "unitetin e popullit dhe garanton funksionimin demokratik të Institucioneve Kalimtare"; i propozon Kuvendit Kryeministrin; dhe i raporton një herë në vit PSSP-së mbi gjendjen e përgjithshme në Kosovë.
- Zgjedh Kryeministrin dhe Ministrat e Qeverisë.
- Zgjedh Presidencën e Kuvendit të përbërë prej shtatë anëtarësh.
- Funksionon përmes Komisioneve që hartojnë ligje dhe bëjnë rekomandime në fushat e tyre përkatëse.

Komisionet "Kryesore" (të detyrueshme) janë:

- Komisioni për Buxhet
- Komisioni për Të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve

Komisionet Funksionale janë:

- Komisioni për Financa dhe Ekonomi
- Komisioni për Tregti dhe Industri
- Komisioni për Arsim, Shkencë dhe Teknologji
- Komisioni për Kulturë, Rini dhe Sporte
- Komisioni për Shëndetësi
- Komisioni për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor
- Komisioni për Punë dhe Mirëqenie Sociale
- Komisioni për Transport dhe Komunikime
- Komisioni për Shërbime Publike
- Komisioni për Agrikulturë, Pylltari dhe Zhvillim Rural
- Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislative dhe Kornizën Kushtetuese
- Komisioni për Ankesa dhe Peticione Publike
- Komisioni për Personat e Zhdukur
- Komisioni për Barazi Gjinore
- Komisioni për Bashkëpunim Ndërkombëtar
- Komisioni për Gatishmëri Emergjente
- Komisioni për Media






## b. Çfarë është Dega Ekzekutive?

Dega Ekzekutive:

- Është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve dhe politikave.
- Përbëhet nga Kryeministri dhe Ministrat dhe ministritë janë nën autoritetin e tyre. Kryeministri dhe Ministrat zgjidhen nga Kuvendi.
- Çdo Ministri këshillohet nga një Zyrtar Kryesor Ndërkombëtar (PIO), i emëruar nga PSSP-ja.
- Ministritë e themeluara janë:
  - Ministria e Financave dhe Ekonomisë
  - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
  - Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
  - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
  - Ministria e Shëndetësisë
  - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
  - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
  - Ministria e Transportit dhe Komunikimeve
  - Ministria e Shërbimeve Publike
  - Ministria e Agrikulturës, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
  - Komisioni Ndërmintrosor për Kthime



### c. Çfarë është Gjyqësori?

- Është dega e qeverisë përgjegjëse për sistemin e drejtësisë në Kosovë, sipas ligjit.
- Përbëhet nga Gjykata Supreme, Gjykatat e 5 Distrikteve, 22 Gjykata Komunale, një Gjykatë Ekonomike, 23 Gjykata për Kundravajtje dhe 13 Zyra Prokurorie.
- Punëson 340 gjykatës dhe prokurorë Kosovarë, 12 gjykatës ndërkombëtarë dhe 6 prokurorë ndërkombëtarë.
- Ministria e Shërbimeve Publike (MShP) e SIKV-së, Gjyqësori Kosovar dhe Këshilli i Prokurorisë janë përgjegjës për emërimin e gjykatësve dhe prokurorëve.
- Megjithatë, PSSP-ja mban autoritetin më të lartë përsa i përket emërimit, shkarkimit dhe disiplinimit të gjykatësve dhe prokurorëve, caktimit të gjykatësve ndërkombëtarë dhe gjithashtu mban autoritet mbi institucionet e zbatimit të ligjeve dhe burgjet.
- MShP-ja në përgjithësi është përgjegjëse për organizimin e gjyqeve, mbulimin e shpenzimeve të gjyqeve, shërbimet e prokurorisë dhe mbështetjen e personelit. Megjithatë, Departamenti i Administratës Gjyqësore, i vendosur në Ministrinë e Shërbimeve Publike, ka përgjegjësi të përditshme për menaxhimin e sistemit gjyqësor. Ai udhëhiqet nga një nëpunës i UNMIK-ut dhe faktikisht aktualisht kontrollohet nga UNMIK-u. Pushtetet kyçe administrative dhe të krijimit të politikave mbi gjyqësorin ngelen nën Departamentin e Drejtësisë së UNMIK-ut.
- Në përgjigje të informatave se kosovarët nuk i besojnë institucioneve gjyqësore, Departamenti i Drejtësisë ka formuar një Grup Punues Strategjik Kalimtar për të adresuar çështjet lidhur me transferimin e pushtetit gjyqësor.

## PUSHTETI I REZERVUAR DHE I TRANSFERUAR: KUSH ËSHTË PËRGJEGJËS PËR ÇFARË?



# Kush është përgjegjës për çfarë?

	Institucioneve Kalimtare të Vetëqeverisjes u janë dhënë "përgjegjësi" të Caktuara.	UNMIK-u/PSSP-ja mban "Autoritetin më të Lartë" përmes "Pushtetit të Rezervuar".
Miratimi i Ligjeve	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Qeveria (Kryeministri dhe Ministrat) ose</li> <li>• Kuvendi hartojnë dhe propozojnë ligje.</li> </ul>	Ligjet nuk hyjnë në fuqi derisa të aprovohen dhe shpallen (zyrtarisht) të vlefshme nga PSSP-ja.
Zbatimi i Ligjeve	<b>Ministrat:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• "udhëheqin dhe përfaqësojnë" Ministrinë;</li> <li>• përgjigjen para Kuvendit;</li> <li>• vendosin drejtimin politik të Ministrisë; dhe</li> <li>• nxjerrin vendime dhe udhëzime administrative për të rregulluar veprimtarinë e Ministrisë.</li> </ul>	<b>PSSP-ja:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• mban "autoritetin më të lartë" për të interpretuar qëllimin dhe parametrat e përgjegjësive ekzekutive të Ministrive;</li> <li>• mund të marrë çfarëdo lloj masash të kërkuara për "të avancuar efektivitetin e Degës Ekzekutive"; dhe</li> <li>• mund "të emërojë ndërkombëtarët dhe personel tjetër në Ministri dhe Agjenci për të kryer funksione të tilla si ta gjykojë ai të duhur e të nevojshme.</li> </ul>
Pushtet për të Zgjedhur dhe Pushtet për të Shpërndarë Kuvendin	Kuvendi është i zgjedhur në mënyrë demokratike nga populli i Kosovës.	PSSP-ja mund ta shpërndajë Kuvendin dhe të lajmërojë zgjedhje të reja.
Autoriteti Fiskal	Institucionet Kalimtare kanë përgjegjësi në fushat e politikave ekonomike dhe financiare, çështjet fiskale dhe buxhetore dhe në ndihmesën që u japin komunave për zhvillimin e buxheteve të tyre dhe sistemeve të menaxhimit financiar. Departamentet brenda Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë kanë ndryshuar për të: <ul style="list-style-type: none"> <li>• zhvilluar, zbatuar dhe menaxhuar Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës;</li> <li>• formuluar politika buxhetore afatmesme;</li> <li>• bërë auditime të autoriteteve publike; dhe</li> <li>• zhvilluar dhe propozuar ligjet e taksave, analizuar ndikimin e taksave.</li> </ul>	<b>PSSP-ja:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• mban autoritetin më të lartë për të aprovuar Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës;</li> <li>• kontrollon politikën monetare;</li> <li>• emëron anëtarët e Këshillit Ekonomik dhe Fiskal, Bordin Qeverisës të Bankave dhe Pagesave, Drejtorët Ekzekutivë të Shërbimit Doganor dhe Inspektoriatit të Taksave dhe Revizorin e Përgjithshëm; dhe</li> <li>• aprovon të gjitha investimet e parave publike.</li> </ul>
Gjyqësori	Institucioneve Kalimtare u është dhënë "përgjegjësi" për marrjen e vendimeve për sa i përket emërimit të gjykatësve dhe prokurorëve.	PSSP-ja ushtron autoritetin më të lartë mbi emërimin, shkarkimin dhe disiplinimin e gjykatësve dhe prokurorëve.
Prona		<b>Pushtet i rezervuar për:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të kontrollojë Drejtorinë e Strehimit dhe Pronës dhe Komisionin e Ankesave për Strehimin;</li> <li>• të administruar pronën dhe ndërmarrjet publike, shtetërore dhe shoqërore; dhe</li> <li>• ruajtur kufijtë aktualë të komunave.</li> </ul>
Marrëdhëniet e Jashtme	Institucionet Kalimtare kanë "përgjegjësi" në "marrëdhëniet e jashtme dhe ndërkombëtare, ku përfshihet arritja dhe finalizimi i marrëveshjeve".	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Veprimtari të tilla "do të koordinohen me PSSP-në".</li> <li>• PSSP-ja rezervon të drejtën për të drejtuar marrëdhëniet e jashtme, të arrijë në përfundime dhe mbikqyrë përmbushjen e marrëveshjeve me shtetet dhe organizatat ndërkombëtare në të gjitha çështjet brenda rezolutës 1244.</li> </ul>
Zbatimi i Ligjit		Pushtet i rezervuar. PSSP-ja ka autoritet mbi Shërbimin Policor të Kosovës, që funksionon nën mbikqyrjen e Policisë së UNMIK-ut.
Mbrojtja, Siguria Civile		I Rezervuar për Praninë Ndërkombëtare për Siguri (KFOR). PSSP-ja bashkëpunon ngushtë me KFOR-in në vëzhgimin e kufirit, rregullimin e çështjes së posedimit të armëve, forcimin e sigurisë dhe rendit publik, ushtrimin e funksioneve të mbrojtjes, gatishmërisë së emergjencës dhe sigurisë civile.



Qytetari ...



... vendos cilin ligj e do



Vendos cilës pjesë të qeverisë dëshiron t'i qaset



Zgjedh Kuvendin dhe dorëzon projekt-ligjin



Kuvendi e dërgon atë tek komisioni përkatës

Komisioni e rishikon projekt-ligjin dhe nëse ai pajtohet e kthen atë në kuvend



Kuvendi e voton projekt-ligjin dhe e aprovon



Projekt-ligji i dërgohet PSSP-së...



...për rishikim dhe aprovim



Nëse aprovohet nga PSSP-ja ...



... Ligji dërgohet në qeveri për zbatim

## PJESËMARRJA E PUBLIKUT/QEVERIA QENDRORE

### a. Si mundet një anëtar i publikut të iniciojë miratimin e një ligji?

Ligjet kalohen nga Kuvendi, por mund të propozohen dhe hartohen nga Departamentet në Degën Ekzekutive; Zyra e Kryeministrit; një Komision i Kuvendit; ose edhe nga një anëtar i publikut. Nëse një anëtar ose grup nga publiku do të propozojë një ligj, si do të duhej t'ia bënëin?

Figura 1: Të vendosin se cilës pjesë të qeverisë do t'i qasen: Kuvendit apo Degës Ekzekutive. Zgjedhja mund të varet nga subjekti i ligjit të propozuar, ose se kush ka shprehur interes në ligj.


Figura 2: Nëse një anëtar i publikut vendos t'i qaset një anëtari të Kuvendit, ai/ajo duhet të bëjë çdo përpjekje për ta bindur Anëtarin e Kuvendit për vlerën e ligjit të propozuar.

Figura 3: Anëtari i Kuvendit do t'ia bëjë propozimin njërit prej Komisioneve - komisionit që ka autoritetin mbi çështjen e ligjit të propozuar. Personi që e propozoi ligjin mund të marrë pjesë në mbledhjen e komisionit kur shqyrtohet ligji. Nëse komisioni vendos kundër ligjit, personi mund t'ia nisë nga e para gjithë punës. Nëse Komisioni e aprovon ligjin, ai do t'i propozohet Kuvendit.

Figura 4: Kuvendi hedh në votim ligjin. Para votimit, ai mund t'i bëjë ndryshime projekt-ligjit.

Figura 5: Nëse Kuvendi e miraton ligjin, ai do të rishikohet nga PSSP-ja. Nëse ligji është në përputhje me Rezolutën 1244 dhe ligjin në fuqi, ai do të duhej të aprovohej. Nëse kështu, PSSP-ja e shpall zyrtarisht të vlefshëm ligjin. Nëse jo, PSSP-ja nuk do ta aprovojë ligjin, dhe personi duhet t'ia nisë sërish nga e para punës.

Figura 6: Sapo PSSP-ja zyrtarisht e shpall të vlefshëm ligjin, është përgjegjësia e Degës Ekzekutive për zbatimin e tij.





# QEVERIA KOMUNALE: Çfarë është Qeveria Komunale?

## 1. Çfarë janë Institucionet Kalimtare të Qeverive Komunale të Kosovës?

Qeveria Komunale përbëhet nga:

Kuvendi;  
Kryetari i Komunës, Zv. Kryetari dhe Departamentet Komunale; dhe  
Administratori Komunal.

Kuvendi:

Përbëhet nga përfaqësuesit e zgjedhur nga populli;  
Vendos politikat dhe miraton rregullore mbi çështje brenda autoritetit të vet;  
Zgjedh Kryetarin e Komunës dhe Zv. Kryetarin nga mesi i anëtarëve të vet; dhe  
Punon përmes Komisioneve, 3 nga të cilat janë të detyrueshme: Politikat/Financat,  
Ndërmjetësimi dhe Komunitetet.

Departamentet Komunale:

Mbikqyren nga Kryetari i Komunës, Drejtori i Ekzekutivit dhe Shefat e Departamenteve (ose Bordi i Drejtorëve);  
Drejtojnë funksionet e përditshme të Komunës; dhe  
Zbatojnë dhe ekzekutojnë vendimet e Kuvendit.

Administratori Komunal i UNMIK-ut:

Aprovon buxhetin dhe menaxhon pronën publike;  
Mund të pezullojë çfarëdo Vendimi të Qeverisjes Komunale në mënyrë që të sigurojë përputhje me Rezolutën 1244 dhe ligjin në fuqi; dhe  
Aprovon emërimet dhe shkarkimet nga Departamentet Komunale për të siguruar proporcion të drejtë përfaqësimi.

## 2. Kush dhe çfarë janë Autoritetet Qeverisëse në Komuna?

Administratorët Komunalë: Pak pas arritjes së UNMIK-ut në vitin 1999, PSSP-ja emëroi ndërkom-bëtarë për të shërbyer si "Administratorë Komunalë" për secilën prej 30 komunave në Kosovë. Puna e Administratorit ishte që të kontrollonte dhe mbikqyrte të gjitha qeveritë vendore dhe funksionet e shërbimit publik në komunën e tyre përkatëse.

Institucionet Kalimtare: Në gusht të vitit 2000, PSSP-ja miratoi Rregulloren 2000/45 mbi "Vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë". Kjo Rregullore themeloi "institucionet kalimtare" - një strukturë e përkohshme qeverisëse për komunat. Institucionet kalimtare të qeverisjes komunale janë Kuvendi dhe Departamentet Komunale.

Zgjedhjet dhe Transferimet e Pushtetit: Në tetor të vitit 2000, u mbajtën zgjedhjet e para komunale për të zgjedhur përfaqësues kosovarë që të shërbejnë në Kuvendet Komunale. Që nga ajo kohë, Administratorët Komunalë të UNMIK-ut kanë filluar transferimin e përgjegjësisë të administrimit të komunës tek kosovarët.

Autoriteti më i lartë: Administratori Komunal dhe PSSP-ja megjithatë ende gëzojnë autoritet mbi çdo veprim, vendim apo politika të marra nga qeveritë komunale vendore.

### 3. Cilat janë përgjegjësitë e Qeverisë Komunale?

Kuvendi Miraton Rregulloret.

Kuvendi është përgjegjës për miratimin e rregulloreve për menaxhimin e punëve publike.

Departamentet Zbatojnë Politikat.

Departamentet Komunale janë përgjegjëse për zbatimin e rregulloreve dhe drejtimin e punëve të përditshme të komunës.

Fushat e Përgjegjësisë së Komunave.

Sipas Rregullores së kaluar nga UNMIK-u (2000/45), Qeveria Komunale duhet të rregullojë dhe menaxhojë punët publike në komunë në fushat e mëposhtme:

Ekonomia Lokale	Planifikimi Rural e Urban dhe Përdorimi i Tokës
Dhënia e Lejeve për Ndërtim	Mbrojtja Lokale e Mjedisit
Rregulloret për Ndërtim	Infrastruktura dhe Shërbimet Publike Lokale
Shërbimet e Zjarrit dhe të Emergjencës	Menaxhimi i Pronës Publike Komunale
Arsimi	Mbrojtja e Konsumatorit dhe Shëndeti Publik
Kujdesi Shëndetësor Primar	Shërbimet Sociale dhe Strehimi
Dhënia e lejeve për shërbime dhe hapësirave ku do të kryhen ato (tregjet ushqimore, taksitë, etj.)	Panairët dhe Tregjet
Emërtimi dhe riemërtimi i bulevardëve, rrugëve dhe vendeve të tjera publike	Sigurimi i parqeve publike, hapësirave dhe varrezave
Zbatimi i rregulloreve të Autoritetit Qendror mbi regjistrimet e Kadastrës, regjistrimet civile dhe regjistrimin e votuesve e të bizneseve	Komunat mund gjithashtu të ndërmarrin veprim mbi turizmin, veprimtaritë kulturore, sportet dhe rekreacionin, veprimtaritë rinore, promovimet ekonomike dhe civile


Të Drejtat e Barabarta dhe Liria. Komuna është gjithashtu e ngarkuar që të sigurojë se banorët i gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë, përfshirë mundësitë e barabarta të punësimit në shërbimet komunale, pa dallime me bazë race, etnie, ngjyre, gjinie, gjuhe, feje, mendimi politik, origjine kombëtare apo sociale, prone, lindjeje apo statusi tjetër.

#### 4. Pjesëmarrja në Qeverinë Komunale

##### a. Si mund të marr pjesë unë në Qeverinë time Komunale?

Si një pjesëtar i publikut, ju e keni të drejtën për të marrë pjesë në vendimet e qeverisjes tuaj komunale. Ka një shumëllojshmëri mënyrash për ta ushtruar këtë të drejtë. Rregulloret e UNMIK-ut dhe statutet e rregulloret komunale jua japin të drejtat për:

- Të dorëzuar një petition në Kuvendin Komunal, për t'i kërkuar që ta marrë parasysh një çështje të veçantë dhe/ose të miratojë një rregullore (shih kapitullin tjetër mbi "Paraqitjen e Peticioneve në Qeverinë Tuaj Komunale").
- Të marrë pjesë në Mbledhjet Publike. Qeveria Komunale duhet të mbajë "mbledhje publike" të paktën dy herë në vit. Këto mbledhje ofrojnë mundësi për të mësuar se çfarë po bën qeveria, drejtuar pyetje dhe shprehur mendimet dhe shqetësimet tuaja.
- T'u njoftuar për mbledhjet e Kuvendit dhe ndjekur ato. Të gjitha mbledhjet e Kuvendit dhe të Komisioneve të tij janë të hapura për publikun dhe nga Qeveria Komunale kërkohet që t'i njoftojë qytetarët se kur dhe ku do të zhvillohen mbledhjet.
- Të inspektuar dokumentat e Qeverisë Komunale. Një qytetar ka të drejtën të inspektojë dokumentet e mbajtura nga Qeveria Komunale - si procesverbalet e mbledhjeve të Kuvendit, rregulloret dhe procedurat, informacionin mbi buxhetin, tenderat e kontratave dhe korrespondencën zyrtare.
- T'u bërë anëtar i njërit prej Komisioneve të Kuvendit. Komisionet mund të kenë disa anëtarë nga publiku që nuk janë anëtarë të Kuvendit.
- Të bërë një ankesë formale për një Vendim Administrativ (shikoni kapitullin tjetër mbi "Ankesat Administrative").




Qytetarët duhet së pari ...

...ta dorëzojnë petitionin tek Kryeshefi i Ekzekutivit (CEO)



Kryeshefi i Ekzekutivit pranon petitionin...



... dhe ia gjuan Kuvendit.  
Kuvendi e dërgon atë tek komisioni përkatës.

Komisioni e rishikon petitionin dhe nëse pajtohet ia kthen atë kuvendit



Kuvendi voton për petitionin dhe e aprovon.




Petitioni dërgohet tek ...



... Administratori Komunal për rishikim përfundimtar.



Nëse aprovohet nga Administratori Komunal petitioni i dërgohet ...



... qeverisë komunale për zbatim.

## b. Si ti bëj peticion Qeverisë time Komunale?

Një qytetar mendon se Qeveria Komunale duhet ta kalojë një rregullore që kërkon inspektimin e mishit, gjë që mundëson shëndetin e mirë të qytetarëve. Si mund ta bëjë qytetari këtë? Qytetari mund t'i "bëjë peticion" qeverisë për ta kaluar rregulloren.

### Çfarë është peticioni?

Peticioni është një kërkesë e shkruar që i adresohet Kuvendit Komunal nga një grup njerëzish. Peticioni i kërkon Kuvendit që të ndërmarrë veprim ose të tërhiqet së ndërmarrë një veprim dhe shpreh vullnetin dhe mendimin e nënshkruesëve mbi një çështje që përbën shqetësim publik.

Çfarë lloj çështjesh mund të jenë subjekt i një peticioni?

Një peticion mund:

- Të propozojë një rregullore të re;
- Të kërkojë që Kuvendi të ndërmarrë rishikimin e një çështjeje të veçantë;
- Të shprehë një mendim rreth legjislacionit që pritet të miratohet; ose
- Të kërkojë një mbledhje publike mbi një temë të veçantë.

Në të vërtetë, një peticion mund të adresojë çfarëdo lloj çështjeje me interes publik apo civil dhe që është brenda kompetencave të Komunës. Kjo mund të përfshijë draftin e një rregulloreje të hartuar nga shkruesit e peticionit.

## 1. Si mund të merret parasysh peticioni i një anëtari të publikut nga Qeveria?

Figura 1: Qytetari duhet së pari t'ia dorëzojë peticionin Kryeshefit të Ekzekutivit.

Figura 2: Kryeshefi i Ekzekutivit duhet t'ia kalojë peticionin Kuvendit brenda një afati të caktuar kohor, të vendosur nga Statuti i Komunës (zakonisht 30 deri në 60 ditë).

Figura 3: Kuvendi mund t'ia kalojë peticionin një Komisioni.

Figura 4: Komisioni mund ta marrë parasysh dhe të bëjë një rekomandim mbi peticionin tek Kuvendi. Shkruesit e peticionit mund të marrin pjesë në mbledhjen e Komisionit kur ai e shqyrton peticionin. Nëse Komisioni nuk ia rekomandon peticionin Kuvendit, Shkruesit e peticionit mund t'ia nisin punën nga e para. Nëse komisioni e aprovon peticionin, i bën një rekomandim Kuvendit për ta kaluar rregulloren e propozuar.

Figura 5: Kuvendi duhet ta marrë parasysh peticionin dhe rregulloren e propozuar brenda një afati të caktuar kohor (zakonisht 30 deri në 90 ditë sipas Statutit Komunal) nga data e marrjes së tij nga Komisioni. Nëse Kuvendi vendos kundër peticionit dhe rregullores së propozuar, shkruesit e peticionit mund t'ia nisin sërish nga e para punën. Nëse Kuvendi e aprovon dhe e kalon rregulloren, Administratori Komunal do ta rishikojë rregulloren.

Figura 6: Administratori Komunal mund të mos e aprovojë rregulloren vetëm nëse ajo nuk përputhet me rezolutën 1244 ose ligjin në fuqi. Nëse e aprovon, rregullorja dërgohet në Shërbimin Civil të Qeverisë Komunale.

Figura 7: Departamenti përkatës në Shërbimin Civil të Qeverisë Komunale zbaton rregulloren.



### c. Si të ankohem për një vendim administrativ?

Një vendim administrativ merret nga një nëpunës civil ose Shefi i Departamentit në emër të Qeverisë Komunale. Ky është vendim i marrë në përditshmërinë normale të kryerjes së funksioneve qeveritare dhe aplikimit të ligjeve dhe rregulloreve. Për shembull, një vendim administrativ mund të jetë:

- Vendosja e një gjobe ose dënimi për shkeljen e ndonjë rregulloreje;
- Një përcaktim lidhur me aplikimin e ndonjë lejeje; ose
- Një përcaktim i kritereve për qasjen në shërbimet publike.

#### Si të Ankohem për një Vendim Administrativ?

• Një ankesë formale për një vendim administrativ (si një gjobë apo dënim i padrejtë, ose mosnjohja e padrejtë e një lejeje) duhet t'i drejtohet Kryeshefit të Ekzekutivit brenda një muaji nga dita e marrjes së vendimit.

• Kryeshefi i Ekzekutivit duhet të vendosë nëse vendimi ishte i ligjshëm dhe konform procedurave të duhura; dhe duhet t'ju japë një vendim të arsyeshëm me shkrim brenda një muaji pas marrjes së ankesës.

- Nëse ju jeni i pakënaqur me përgjigjen, ju mund ta dërgoni ankesën tuaj tek PSSP-ja.

## Mirënjohje

I falenderohemi Cathy Shea, ICNL, Simon Chesterman, Akademia për Paqe Ndërkombëtare, Nebi Qena, Garentina Kraja, Gjyljeta Mushkolaj, IKDO dhe Aleksandër Dardeli, EWMI, për komentet dhe sugjerimet e tyre të vlefshme në këtë udhëzues.







EAST · WEST  
MANAGEMENT  
INSTITUTE



# Canadä



FONDACIONI PËR INICIATIVË DEMOKRATIKE  
FOUNDATION FOR DEMOCRATIC INITIATIVES

